



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1702 Prot

Gjirokastrë, më 07.11. 2024

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaha ÇANA



Lënda: Hapen thirrjet për shërbim projekt propozimesh në kuadër të Programit të Fondit të Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP), pranë Ambasadës së SHBA në Shqipëri.

Në kuadër të Programit të Fondit të Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP), janë hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të propozimit
1	Programit i Fondit të Ambasadorëve për Trashëgiminë Kulturore (AFCP))	13 dhjetor 2024

Ky program ka për qëllim të mbështesë ruajtjen e ndërtesave historike, vendeve arkeologjike, dorëshkrimeve, koleksioneve muzeale dhe formave të shprehjes kulturore tradicionale si gjuhët dhe zanatet indigjene në më shumë se 120 vende të botës.

Procesi i aplikimit është i shtrirë në dy faza:

- në fazën e parë bëhet aplikimi i projekt idesë në formën e "concept note" deri më datë 13 dhjetor 2024.
- në fazën e dytë Ambasada e Shteteve të Bashkuara fton të përzgjedhurit e fazës së parë të aplikojnë projekt propozimin e plotë deri më datë 30 Mars 2025.

Aktivitetet kryesore që mbështet ky program janë si vijon:

- Anastiloza - montimi i një vendi me pjesët e tij origjinale.
- Ruajtja - adresimi i dëmtimit të një objekti.
- Konsolidimi - lidhja ose rilidhja e elementëve të një objekti ose vendi
- Dokumentacioni - regjistrimi i gjendjes dhe veçorive të rëndësishme të një objekti, vendi ose tradite në format analog ose dixhital.
- Inventari - renditja e objekteve, vendeve ose traditave sipas vendndodhjes, veçorisë, moshës ose karakteristikave të tjera unifikuese.
- Konservimi parandalues - adresimi i kushteve që kërcënojnë ose dëmtojnë një vend, objekt, koleksion ose traditë.
- Restaurimi - zëvendësimi i elementeve që mungojnë për të rikrijuar pamjen origjinale të një objekti ose vendi, zakonisht të përshtatshëm për artet e bukura, artet dekorative dhe ndërtesat historike.

Thirrjen, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri (<https://al.usembassy.gov/ambassadors-fund-for-cultural-preservation-afcp/>).

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

